



Australian Government



# Vaksinat kundër COVID-19 për fëmijë dhe tinxherë: informacione për prindët dhe kujdestarët

Përditësuar së fundi herë: 10 janar 2022

Vaksina kundër COVID-19 është e miratuar dhe rekomanduar për njerëzit e moshës 5 vjeç e lartë. Terminet për vaksinim kundër COVID-19 për fëmijët e moshës 5 vjeç e lartë tani janë në dispozicion.

Spikevax (Moderna) është e miratuar dhe rekomanduar për njerëzit e moshës 12 vjeç e lartë. Momentalisht është duke u vlerësuar për fëmijët e moshës 6 deri 11 vjeçare.

## Pse fëmijët dhe tinxherët duhet të vaksinohen?

Ka shumë arsye që fëmijët dhe tinxherët të vaksinohen kundër COVID-19, përfshirë:

- të mbrojnë veten nga kapja e COVID-19
- zvogëlimin e rrezikut të të sëmurit rëndë, efektet anësore afatgjata apo COVID afagjatë
- të ndihmojnë në kthimin në shkollë
- rilidhen me familjen dhe miqtë e tyre
- kthimi në gjërat që kënaqen, siç janë sportet ekipore, shkuarja në koncerte dhe udhëtimi, dhe
- ngadalësimin e përhapjes së virusit në komunitet.

Vaksinimi kundër COVID-19 gjithashtu mbronë:

- familjen
- miqtë
- shokët e shkollës, dhe
- shokët e ekipit.

## Si funksionojnë vaksinat për COVID-19?

Vaksinat kundër COVID-19 mund të ndalojnë që njerëzit që të sëmuren rëndë me COVID-19. Vaksinat mësojnë trupin tuaj të çlirohen nga COVID-19 nëse bini në kontakt me atë.

Vaksinat Pfizer dhe Moderna nuk përmbajnë ndonjë virus të gjallë dhe nuk mund t'ju japin COVID-19.

## Çfarë të prisni pas vaksinimit

Vaksina fillon të mbrojë njerëzit nga COVID-19 diku 2 deri 3 javë pas dozës së parë.

Kjo është arsyeja pse është me rëndësi që fëmija juaj të vazhdon të jetë i sigurt dhe:

- praktikoni higjienë të mirë, sikurse larja e duarve të tyre
- mbajnë distancë prej 1.5 metrave nga njerëzit e tjerë
- ndjekin kufizimet për grumbullime publike, dhe
- kuptojnë se kur dhe si të izoloohen nëse kanë nevojë.

## A do të kenë ata efekte anësore?

Fëmija juaj mund të ketë efekte anësore pas vaksinimit. Shumica e efekteve anësore zgjasin jo më shumë se disa ditë, kurse ata do të shërohen pa ndonjë problem. Reaksionet e zakonshme të vaksinimit përfshijnë:

- skuqje të krahut
- ethe të buta
- dhimbje koke.

Nëse keni ndonjë shqetësim në lidhje me simptomat e fëmijës, më shumë informacione mund të merrni në [www.health.gov.au](http://www.health.gov.au) apo thirrni National Coronavirus Helpline në **1800 020 080**. Për shërbime përkthimi, thirrni **131 450** dhe kërkoni National Coronavirus Helpline.

Gjithashtu mund të diskutoni ndonjë shqetësim apo pyetje që keni në lidhje me vaksinimin kundër COVID-19 me mjekun tuaj apo profesionistin për kujdes shëndetësor para se fëmija juaj të merr vaksinën.

## Cilën vaksinë do ta merr fëmija im?

Ka disa dallime tek vaksinat kundër COVID-19 për fëmijët e moshës 5 deri 11 vjeçare dhe për njerëzit e moshës 12 vjeç e lartë.

Fëmijët e moshës 5 deri 11 vjeçare do të marrin 2 doza të vaksinës, 8 javë larg njëra tjetrës. Kjo mund të shkurtrohet deri në minimum prej 3 javëve në rrethana të veçanta. Doza për fëmijët e moshës 5 deri 11 vjeçare është një e treta e dozës për njerëzit e moshës 12 vjeç e lartë.

Fëmijët e moshës 12 vjeçare e lartë do të marrin 2 doza të vaksinës, 3 deri 6 javë larg njëra tjetrës.

## Mbani mend terminin e tyre të dytë

Me rëndësi është që fëmija juaj të merr dy doza të vaksinës, pasi që doza e dyte jep mbrojtjen e plotë kundër COVID-19 dhe siguron që mbrojtja të zgjat më shumë.

## Pëlqim

Prindëve mund t'ju kërkohet të japin pëlqim për fëmijën e tyre që vaksinohet.

Në përgjithësi, një prind apo kujdestar ligjor i fëmijërs ka autoritetin të jep pëlqimin për vaksinim. Në disa shtete dhe territore, adoleshentët e rritur mund të japin pëlqimin për vete.

Vaksina kundër COVID-19 e fëmijës tuaj do të shënohet në Immunisation History Statement. Nëse fëmija është 14 vjeç e lartë, nuk do të mund të keni qasje më në Australian Immunisation Record për arsye të privatësisë. Mund të merrni Shënimin e tyre australian për imunizim (immunisation history statement) nëse merrni pëlqimin e tyre. Më shumë informacione janë në dispozicion përmes Services Australia <https://www.servicesaustralia.gov.au/how-to-get-immunisation-history-statement>

## Më shumë informacione

Për më shumë informacione në lidhje me vaksinat kundër COVID-19, vizitoni [www.health.gov.au/covid19-vaccines-languages](http://www.health.gov.au/covid19-vaccines-languages) apo thirrni National Coronavirus Helpline në **1800 020 080**. Për shërbime përkthimi, thirrni **131 450** dhe kërkoni National Coronavirus Helpline.